



**Datë:** 16.02.2026

**Numër Protokolli:** 1053/2026

**A.nr.132/2026**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.132/2026, të datës 04.02.2026, të parashtruar nga ankuesi A.H, kundër organit të Ministrisë së Mbrojtjes, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.02.2026, mori këtë:

## V E N D I M

**Hedhet poshtë si e parakohshme** ankesa me numër A.nr.132/2026, e datës 04.02.2026, e parashtruar nga ankuesi A.H.

## A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, A.H (*në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi*), sipas Konkursit me numër reference RN00017454, të shpallur me datë 27.03.2025, nga Ministria e Mbrojtjes, për pozitën e punës Inspektor i përgjithshëm, në kuadër të Departamentit të Inspektorit Gjeneral, me datë 04.02.2026 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me shkeljen e të drejtës për qasjen në testin me shkrim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.02.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Mbrojtjes, ndërsa ky i fundit me datë 13.02.2026, ka dorëzuar përgjigjën me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit*) nga shqyrtimi dhe analizimi i shkresave të bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se Ministria e Mbrojtjes, me datë 27.03.2025 ka shpallur konkursin me numër Reference RN00017454, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, gjegjësisht për pozitën Inspektor i Përgjithshëm, klasa profesional 1, në kuadër të Departamentit të Inspektorit Gjeneral, me afat aplikimi nga data 28.03.2025 deri më datë 26.04.2025.

Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës rrjedhë se në konkursin përkatës ka aplikuar edhe ankuesi, i cili nga faza e testit me shkrim ka arritur gjithsejtë 42.6 pikë, të pamjaftueshme për të vazhduar tutje me vlerësimin e intervistës me gojë.

Ankuesi me datë 04.02.2026 ka parashtruar ankesë në Këshill, me pretendimet lidhur me shkeljen e të drejtës për qasjen të testimit e zhvilluar, duke theksuar se pas përfundimit të testit me shkrim kam kërkuar qasjen në testin me shkrim, përkatësisht shikimin e pyetjeve, përgjigjeve dhe vlerësimit të esesë me qëllim të verifikimit të saktësisë dhe transparencës së procesit të vlerësimi, por megjithatë deri më tani nuk i është mundësuar një qasje e tillë dhe as nuk ka pranuar përgjigje të arsyetuar lidhur me këtë kërkesë. Rrjedhimisht, kërkon aprovimin e ankesës, me obligimin e autoritetit përkatës që ankuesit ti mundësohet qasja e plotë në testin me shkrim, përfshirë vlerësimin e esesë dhe të ndërmerren masat e nevojshme ligjore për garantimin e transparencës së procedurës së rekrutimit.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 39 paragrafi 12 ku përcaktohet se: *12. Kandidatet/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative.* si dhe nenit 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimin në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *17. Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve.*

Referuar kuadrin ligjor përkatës si dhe duke u bazuar në provat e administruara të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesi më datë 04.02.2026, lidhur me pretendimin ankimor për ndërmarrjen e masave të nevojshme ligjore për garantimin e transparencës së procedurës së rekrutimit, është e parakohshme, ngase sipas dispozitave përkatëse ligjore, kandidati për pranim në shërbim civil ka të drejtë të parashtror ankesë vetëm pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, ndërsa, në rastin konkret ankuesi ka dorëzuar ankesën ende pa u publikuar Njoftimi i të datës 05.02.2026, i Departamentit të Politikave të Personelit dhe Rekrutimit të Ministrisë së Mbrojtjes, për rezultatet përfundimtare të procesit të rekrutimit për pozitën e punës “Inspektor i Përgjithshëm”, në kuadër të Departamentit të Inspektorit Gjeneral, të Ministrisë së Mbrojtjes.

Andaj, duke qenë se ankesa është parashtruar ende pa u shpallur njoftimi për rezultatin përfundimtar për procedurën përkatëse të rekrutimit, atëherë, në kuptim të dispozitave të nenit 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për

Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e njëjta është e papranueshme, kështu që, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi të hedhë poshtë si të parakohshme ankesën A.nr.132/2026, të datës 04.02.2026, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Lidhur me të drejtën në mjete juridike, Kolegji i Këshillit thekson faktin së hedhja poshtë e ankesës si parakohshme, nuk mohon të drejtën e ankuesit, që me ankesë të re të kundërshtoj rezultatet e testit me shkrim, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare si akt mbi përfundimin e konkursit lidhur me pozitën përkatëse.

Ndërsa, lidhur me pretendimin për obligimin e autoritetit përkatës që ankuesit ti mundësohet qasja e plotë në testin me shkrim, përfshirë vlerësimin e esesë, ankuesi në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-081 për Qasjen në Dokumente Publike në Republikën e Kosovës, mund ti drejtohet Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP), e cila është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e këtij ligji.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.132/2026**

**Atdhe GASHI**

\_\_\_\_\_  
**Procesmbajtës**

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

\_\_\_\_\_  
**Kryetare e Kolegjit**

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit A.H;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.